

Neni 16

Rregullat e kryerjes së VAP

-Kandidatët që do të nënshtrohen vlerësimit të aftësimit praktik duhet të zbatojnë rregullat e mëposhtme:

1. Të jenë të pajisur me kartë identiteti ose pasaporte;
2. Të paraqiten 30 minuta para fillimit të vlerësimit;
3. Të jenë të pajisur me mjetet e nevojshme për zhvillimin e testimit;
4. Ndalohet marrja me vete dhe përdorimi i celulareve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të vlerësimit, pasi kjo konsiderohet si kriter skualifikimi;
5. Ndalohet duhani, alkooli dhe konsumimi i ushqimit në mjediset ku zhvillohet testimi;
6. Ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të vlerësimit të aftësimit praktik;
7. KVAP është përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e procesit.